



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafit 4 i Ligjit nr. 04/L – 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, merr këtë

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme, në pronësi të Komunës, me pronën e paluajtshme, në bashkëpronësi të: Met Zogajt, Nexhat Lahut, Ismet Lahut dhe Xhemile Zhushit.

Neni 2

Me këtë vendim lejohet këmbimi i:

pronës së paluajtshme, në pronësi të Komunës, pjesë e parcelës nr. 1412 - 0, Certifikata e pronësisë nr. P – 71914050 – 01412 - 0 , Zona kadastrale Matiçan, me

pronën e paluajtshme, në bashkëpronësi të Met Zogajt, Nexhat Lahut, Ismet Lahut dhe Xhemile Zhushit, pjesë e parcelës kadastrale nr. 1540 – 0, Certifikata e pronësisë nr. P – 71914050 – 01540 – 0, Zona kadastrale Matiçan.

Neni 3

Para shpalljes publike të vendimit, Komuna do të sigurojë vlerësimin e kualifikuar e të pavarur të vlerës së tregut të secilës pronë komunale dhe pronës në pronësi të personave fizikë.

Neni 4

Këmbimi i cekur në pikën II të këtij vendimi, do të publikohet në ueb-faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve, me të dhënat e pronave të këmbyerë, vlerën e tyre, si dhe emrin e pronarit me të cilin është bërë këmbimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 035-121636 , më 19.05.2016



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.